



Paga e jetesës bazë
ndërkufitare në Evropë

**Një tjetër
Pagë është
e mundur.**

**Clean
Clothes
Campaign**



Markat e njohura duhet të paguajnë çmimin e plotë të konfeksionit.

Kjo përfshin edhe një pagë
me të cilën punëtori ta
përballojë jetesën.

Ndonëse e drejta për pagë jetese është një e drejtë e
njeriut, pagat e punëtorëve janë shumë larg saj. Studimet
më të fundit riafirmuan hendekun e madh mes pagave të
jetesës dhe shpërblimit kulturor të punëtorëve.

Pse fokusohemi te paga e jetesës

Blerësi duhet të paguajë çmimin e plotë të një robe, çmim ky që përfshin pagën me të cilën punëtori të mund të përballojë jetesën.

Kjo është logjike dhe objekt debati të gjerë politik mes aktorëve kryesorë në industrinë globale të tekstilit dhe veshjeve sportive. Edhe pse e drejta për pagë jetese është e drejtë njerëzore, pagat e punëtorëve janë shumë larg pagës së jetesës. Studimet më të fundit konfirmojnë sërish hendekun e madh ndërmjet pagave të jetesës dhe shpërblimit aktual të punëtorëve.¹ Në fakt, ndërkohë që **hendeku ndërmjet rrogave aktuale të punëtorëve dhe pagës së jetesës pritet të jetë më i madh në vendet e prodhimit të tekstileve në Evropë sesa në Azi,**² niveli i përgjithshëm i formimit të sindikatave³ pritet të jetë më i ulët në Evropë sesa në Azi, sidomos në industrinë e veshjeve.

E drejta e njeriut për pagën e jetesës është kodifikuar prej institucioneve të OKB-së dhe institucioneve evropiane.

“Gjithkush që punon ka të drejtën për një shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që t’i sigurojë atij dhe familjes së vet një ekzistencë në lartësinë e dinjitetit njerëzor”

(Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 23, pika 3).

Në kontekstin evropian, **Karta Evropiane Sociale** e Këshillit të Evropës (ESC 1965) dhe versioni i saj i rishikuar i vitit 1999 e kodifikojnë të drejtën për pagën e jetesës në nenin 4, pika 1: “të njohin të drejtën e punëtorëve për një shpërblim të tillë që u jep atyre dhe familjeve të tyre një standard të denjë jetese”.⁴ ESC njihet në të gjithë Evropën dhe jo vetëm në shtetet anëtare të BE-së. Në vitin 2017,

Bashkimi Evropian ngriti Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale (EPSR),⁵ e cila i referohet “të drejtës për paga të drejta që ofrojnë një standard të denjë jetese” (EPSR).

Objekti dhe objektivi i këtyre traktateve janë shtetet. Që nga viti 2011, Parimet Udhëheqëse të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut kanë parashikuar detyrimin e kompanive për të respektuar të drejtat e njeriut.

Paga e jetesës është e drejtë thelbësore e njeriut dhe jetike për çdo zhvillim të vërtet socio-ekonomik

Disa shitës pakice dhe marka e njohin parimisht të drejtën për pagë jetese në nismat dhe kodet e tyre vullnetare. Megjithatë, në praktikë, shpesh vetëm sa monitorojnë respektimin e pagës minimale ligjore nga furnitorët në një kontekst vendor të caktuar. Në praktikë, pothuaj asnjë prej tyre nuk garanton pagën e jetesës.⁶

Ndërkohë, qeveritë në rajonet prodhuese, si në Evropën Qendrore dhe Lindore, i mbajnë **pagat minimale sa më poshtë të jetë e mundur, mesatarisht sa çereku i pagës së jetesës**, duke krahasuar vazhdimisht normat e pagave me vendet konkurrencte dhe duke mbajtur në mendje rrezikun që markat të zhvendosin biznesin dhe t’ua ndërpresin porositë. Kërcënimi i zhvendosjes së biznesit është një pengesë madhore në negociatat kolektive për pagat që frenon ndjeshëm organizimin e fuqisë punëtore. Nisur nga balancat e pushtetit për mekanizmat e përcaktimit të pagës minimale kombëtare dhe ndërmjet qeverive të shteteve, Komisionit Evropian dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, nuk është habi që qeveritë pranojnë varfërinë e rrezikshme të punëtorëve që fitojnë paga minimale. Pagat minimale negociohen politikisht në bazë parametrash ku kostot e jetesës luajnë rol të pakët, në mos asnjë lloj roli.

1. Clean Clothes Campaign/Bukë për Botën (2020): Shfrytëzimi që bëhet në Evropë. Abuzimet me të drejtat e njeriut në kapononet e prodhimit për markat gjermane të modës në Ukrainë, Serbi, Kroaci dhe Bullgari. Studimet e mëparshme përfshijnë: Clean Clothes Campaign (2014): Stitched Up – Pagat e varfërisë në industrinë e tekstilit në Evropën Lindore dhe Turqi.

Të gjitha burimet: <https://cleanclothes.org/campaigns/living-wages-in-europe>

2. Stitched Up – Pagat e varfërisë në industrinë e tekstilit në Evropën Lindore dhe Turqi, fq. 34/35: <https://cleanclothes.org/file-repository/resources-publications-stitched-up-1/view> – last accessed 15/2/2020. Please also see the CCC’s Shihni edhe profilin vendeve të CCC-së nga rajoni: <https://cleanclothes.org/campaigns/living-wages-in-europe> – vizituar për herë të fundit më 15/2/2020.

3. Kurz Vandaele / ETUI (2019): Premisat e zymta: hartëzimi i anëtarësisë së sindikatave në Evropë që në vitin 2000. <https://www.etui.org/Publications2/Books/Bleak-prospects-mapping-trade-union-membership-in-Europe-since-2000>

4. Karta Evropiane Sociale, gjendet në: <https://rm.coe.int/168006b642>

5. Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale, fq. 15. https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/social-summit-european-pillar-social-rights-booklet_en.pdf

6. Shih CCC (2019): Pagat e Qepura, <https://archive.cleanclothes.org/resources/publications/tailored-wages-2019-the-state-of-pay-in-the-global-garment-industry>

Paga e jetesës është e drejtë njerëzore kyçe që e mundëson njeriun, si edhe jetike për çdo zhvillim real socio-ekonomik.

Qeveritë në rajonet prodhuese si Evropa qendrore, lindore dhe jugore, i mbajnë pagat minimale sa më të ulëta, mesatarisht sa çereku i nivelit të pagës së jetesës (shih tabelën), duke krahasuar vazhdimisht normat e pagave me ato të vendeve konkurruese dhe duke pasur parasysh rrezikun që markat e njohura të zhvendosin biznesin.

Tabela: Paga minimale neto ligjore dhe kufiri i varfërisë, 2018

Shtetet	Minimumi ligjor	Kufiri i varfërisë i BE-së ⁸		Paga minimale neto ligjore
		Paga minimale neto ligjore (2018) në PME sipas CCC-ve në vend	BE-SILC rreziku i pragut të varfërisë në familjet PME, 2018 (mujore) ⁹	Paga minimale neto ligjore si përqindje e kufirit të varfërisë
Republika Çeke	13,352	25,122		53%
Hungaria	126,770	176,094		72%
Sllovakia	397	784		51%
Polonia	1,530	2,938		52%
Bullgaria	395	737		54%
Turqia	1,603	1,629		98%
Kroacia	2,752	5,219		53%
Rumania	1,194	1,575		76%
Serbia	24,882	34,892		71%
Bosnjë-Hercegovinë	440		514	86%
Gjeorgjia	16		500	3%
Maqedonia e Veriut	12,165	16,975		72%
Shqipëria	21,312		26,131	82%
Ukraina	2,997		4,282	70%
Moldavia	2,172		2,738	79%
MESATARJA				65%

Në shumicën e vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, mekanizmi për përcaktimin e pagës minimale supozohet të negociohet nga tri palë (ministria e punës, shoqata e punëdhënësve dhe sindikatat) dhe të përshtatet çdo vit. Në shumë vende, organet trepalëshe nuk marrin vendime; nëse nuk gjejnë konsensus, vendos qeveria. Për shembull, në vitin 2018, në Bullgari, Kroaci, Republikën Çeke, Poloni e Sllovaki, partnerët socialë nuk ranë dakord për nivelin e pagës minimale në fund të konsultimeve dhe negociatave në organet kombëtare trepalëshe. Pastaj, qeveria e vendosi nivelin në mënyrë të njëanshme.⁷

Ka një disbalancë të theksuar të pushtetit dhe influencës ndërmjet qeverisë, shoqatave të punëdhënësve dhe sindikatave, por edhe kundrejt aktorëve të tjerë lobues si Dhoma Amerikane e Tregtisë, Banka Qendrore Evropiane, FMN-ja dhe Komisioni Evropian. Axhenda e politikave të tyre ekonomike ka shumë peshë në përcaktimin e pagave minimale ligjore.

Pagat minimale ligjore kundrejt pragut të varfërisë të BE-së

Tabela tregon se të gjitha pagat minimale neto ligjore janë poshtë kufirit statistikor të varfërisë sipas përkufizimit të BE-së. Mesatarisht, paga minimale ligjore arrin vetëm 2/3 të kufirit të varfërisë. Pagat minimale ligjore nuk ofrojnë imunitet ndaj varfërisë. Punëtorët që fitojnë pagë minimale

ligjore (si shumica e punëtorëve në industrinë tekstile) janë tejet të varfër, edhe sipas pragut të varfërisë të vetë BE-së.

Paga minimale ligjore nuk garanton se punëtorët nuk do të bien në varfëri; përkundrazi, ajo është shenjë e të qenit i varfër.

Kjo situatë rrit nevojën për të forcuar përpjekjet për një pagë me të cilën punëtorët të mundin të përballojnë jetesën.

Me konceptin tonë për një pagë jetese bazë ndërkufitare, synojmë të intensifikojmë përpjekjet urgjente për pagat e jetesës dhe të mbështetim fuqinë negociuese kolektive të sindikatave. Me vendosjen e Pagës Minimale në Evropë, dëshirojmë të lehtësojmë marrjen e masave konkrete dhe të zbatueshme për arritjen e pagave më të larta për punëtorët e industrisë së veshjeve. Ne kemi për qëllim të arrijmë një jetë të denjë dhe me dinjitet për punëtorët e Evropës qendrore, ligjore dhe juglindore.

⁷ Eurofound (2019) Pagat minimale në 2019: Vlerësim Vjetor, Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg, fq. 15

⁸ Burimet: Paga minimale neto ligjore dhe paga mesatare sipas studiesve të CCC nga vendet përkatëse; BE-SILC: Statistikat e BE-së për Të ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (BE-SILC) ku "rreziku i pragut të varfërisë për 60% të mesatares kombëtare ishte e barabartë me të ardhurat për konsum (pas transfertave sociale) për dy të rritur dhe dy fëmijë: http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=silc_li01&lang=en

⁹ Në mungesë të pragjeve të varfërisë BE-SILC, kemi përdorur 60% të pagës mesatare kombëtare.



**Paga minimale
ligjore nuk e
shpëton punëtorin
nga varfëria;
përkundrazi,
tregon se ai
është i varfër.**

Paguani punëtorët me

PAGË JETESE



Ata duhet të jenë
në gjendje të
përballojnë:



Paga e jetesës është një e
drejtë njerëzore, për të
GJITHË njerëzit, në të
GJITHË botën

PUNËTORI
MBAN JO
VETËM
VETEN

1 X PUNËTOR

2 x të rritur nën përgjegjësinë e vet ose
1 x të rritur + 2 fëmijë ose
4 x fëmijë



Përcaktimi i pagës së jetesës

Gjatë viteve të fundit, ekspertët dhe aktorët e interesit kanë rënë dakord gjerësisht për **karakteristikat kryesore të pagës së jetesës**, të cilat janë:

Si një e drejtë universale e njeriut, ajo vlen për **të gjithë** punëtorët, pavarësisht statusit të tyre në vendin e punës, produktivitetit apo situatës së tyre personale (p.sh. gjendja civile). Është paga më e ulët e paguar dhe asnjë punëtor nuk duhet të paguhet më pak sesa paga e përcaktuar e jetesës.

- Ajo duhet të jetë gjithmonë e mjaftueshme për plotësimin e **nevojave bazë** të punëtorëve - duke përfshirë ushqimin, veshjen, strehimin, transportin publik, shpenzimet për ujë, drita dhe telefon, arsimimin, kohën e lirë dhe kulturën, shëndetin normal dhe higjienën, si dhe pushimet (një udhëtim një-javor brenda vendit) – ¹⁰

- dhe ato të **familjeve** të tyre, që shkojnë përtej thjesht mbijetesës, dhe që mundësojnë pjesëmarrje të familjes në jetën shoqërore.

Paga e jetesës duhet të garantojë **të ardhura specifike** për raste emergjence.

- Duhet të fitohet gjatë **orarit normal të punës**, pra, pa orë pune jashtë orarit.

- Clean Clothes Campaign gjithashtu gjykon se paga e jetesës është një **pagë bazë neto** për **një javë të zakonshme pune** pa llogaritur orët jashtë orarit, bonuset, shpërblimet dhe taksat dhe se ajo duhet të paguhet në para të thata (cash).

- Paga e jetesës është një kategori që përfshin vetëm kostot e jetesës. Produktiviteti apo kapaciteti ekonomik i një punëdhënësi **nuk** merren parasysh. Nga ana tjetër, pagat minimale ligjore janë politika që bazohen te tregu dhe përcaktohen në përputhje me avantazhet konkurruese ekonomike të vendit. Megjithatë, paga minimale dhe paga e jetesës janë të ngjashme në kuptimin që synojnë që punëtorët me paga të ulëta të kenë të ardhura të mjaftueshme.

10. Organizata Ndërkombëtare e Punës (1977) Punësimi, Rritja dhe Nevojat Bazë: problem botëror: Strategjia ndërkombëtare e "Nevojave Bazë" kundër varfërisë kronike, përgatitur nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, ILO, dhe vendimet e Konferencës Botërore të Punësimit të vitit 1976, Këshillit të Zhvillimit jashtë Shtetit dhe Zyrës Ndërkombëtare të Punës, Praeger, fq. 32

Me qasjen ndërkufitare, synimi ynë është të sfidojmë kërcënimin e vazhdueshëm të zhvendosjes së biznesit dhe përballimin e konkurrencës në kurriz të pagave.

Modeli aktual i rritjes së shpejtë globale të industrisë tekstile sjell nevojën për një politikë që lufton konkurrencën e zhvendosjes së biznesit ndërmjet shteteve/rajoneve në kurriz të pagave.

**Pagat minimale janë mesatarisht
sa 2/3 e kufirit të varfërisë në BE**

**PAGA MINIMALE
LIGJORE**

KUFIRI I VARFËRISË



Diskutimet aktuale për pagën e jetesës fokusohen më pak te dallimet mes përkufizimeve dhe më shumë te aspekti se si të vihet në zbatim paga e jetesës.

Një vlerësim apo parametër është parakusht për të hedhur hapa të matshëm konkretë drejt zbatimit të pagës së jetesës. Grupi Clean Clothes Campaign në vendet evropiane me industri prodhuese tekstili – kryesisht në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore – kanë filluar përgatitjen e një **parametri ndërkufitar me në qendër punëtorët për të arritur te një pagë jetese bazë në Evropë**. Pas një procesi hap pas hapi, me diskutime dhe analiza, hulumtimeve dhe vrojtimit që filloi në vitin 2014, grupi më në fund miratoi në prill 2020 konceptin e një page jetese bazë ndërkufitare në Evropë.

Themelet e këtij procesi ishin hedhur që me Pagën Minimale në Azi.

Qëllimi ynë ishte që vlerësimi i pagës së jetesës bazë ndërkufitare të ishte **i thjeshtë dhe i lehtë** për t'u kuptuar. Burimet e kufizuara nuk krijojnë mundësi për studime të zgjeruara dhe të vazhdueshme. Për këtë arsye, mendojmë se metoda e përdorur nga Aleanca e Azisë për Pagën Minimale është e drejtë sa u përket karakteristikave të sipërpërmendura: në bazë të ligjit të Engel, ajo përqendrohet tek ushqimi dhe më pak te nevojat e tjera bazë dhe shpenzimet.

Pse paga e jetesës duhet të jetë koncept global?

Në përcaktimin e standardeve të duhura për pagat e jetesës, ne synojmë të shohim **prtej kufijve kombëtarë**. Duke qenë një koncept që synon të ketë në qendër

punëtorët, ai duhet të marrë në konsideratë modelin global të biznesit të modës së prodhimit në masë. Dinamikat e zinxhirëve globalë të furnizimit favorizojnë markat dhe shitësit e pakicës. Teksa markat dhe shitësit me pakicë marrin rolin e përcaktuesve të çmimit, furnitorëve nuk u ngelet gjë tjetër veçse të pranojnë çmimet që u ofrohen. Kështu, markat e njohura dhe shitësit e pakicës kontrollojnë se si vlera shpërndahet në zinxhirin e furnizimit, si dhe kur dhe kur duhet të ndodhë fabrikimi. Prandaj, këto firma i quajmë punëdhënësit kryesorë. Industria e prodhimit të veshjeve përfaqëson shembullin tipik të zinxhirit të vlerës që nxitet nga blerësi. Markat dhe shitësit e pakicës mund të quhen **punëdhënës kryesorë**.

Me një qasje ndërkufitare, synimi ynë është të sfidojmë kërcënimin konstant të zhvendosjes së biznesit dhe konkurrencën e bazuar te pagat. **Me modelin global të biznesit të modës së prodhimit në masë, lind edhe nevoja për hartimin e një politike që lufton konkurrencën e zhvendosjes së industrive nga një vend/rajon në tjetrin në kurriz të pagave – e që prapëseprapë nuk sjell barazi mes vendeve të ndryshme**. Pikërisht këtë synim kemi ndjekur me Pagën Minimale në Evropë. Qëllimi ynë është që t'i vihet kufi "garës për pagën më të ulët" mes vendeve evropiane të prodhimit të veshjeve dhe brendapërbrenda secilit prej tyre.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Paga Minimale në Evropë është e vetmja llogaritje e mundshme. Përkundrazi: **pagat e jetesës ndërkufitare dhe kombëtare plotësojnë njëra-tjetrën**. Ne i shmangemi kurthit të llogaritjes së pagës së përsosur, pasi një gjë e tillë nuk ekziston. Standardi i propozuar nga Clean Clothes Campaign nuk përjashton hapësirat për politika devijuese nga ky standard. Ky standard mund të përshtatet më tej nga sindikatat e vendeve, bazuar në nevojat dhe kontekstet e tyre.

Si llogaritet paga e jetesës si parametër/standard?

Cilat parime të llogaritjes huazuar nga Aleanca e Pagës Minimale Aziatike (AFW)?

Metoda e llogaritjes së AFW-së i ndan shpenzimet familjare në dy kategori: ushqimore dhe joushqimore, duke marrë shpenzimet ushqimore si tregues kryesor i mirëqenies.

AFW-ja e shpreh komponentin ushqimor me kalori dhe jo me artikuj ushqimorë. Qëllimi është të sigurojë një bazë të përbashkët mes shteteve dhe kulturave ushqimore. Shifra kalorike bazohet në studimet e realizuara nga organet shtetërore dhe ndërshtetërore për llogaritjen e kalorive që marrin punëtorët në vendet aziatike¹¹. Aleanca AFW ka marrë për bazë shifrën relativisht të lartë të qeverisë indoneziane prej 3 000 kalorish në ditë, me argumentin se paga minimale nuk duhet të rezultojë në uljen e standardeve të asnjë shteti dhe nuk duhet të nxisë zhvlerësimin e punës së grave në industrinë e prodhimit të veshjeve. Kështu, edhe ne vendosëm të marrim standardin **3 000 kalori në ditë** si standard për Evropën.

Tipar themelor si i Pagës Minimale në Azi, ashtu edhe i Pagës Minimale në Evropë, është **ndjeshmëria gjinore**. Në shumicën e vendeve të prodhimit në Evropë, punëtorët e industrisë së veshjeve janë shpesh ato që sigurojnë jetesën e familjes, që zakonisht janë gra ose kryefamiljare. Bashkëshortët¹² janë shpesh të papunë, angazhohen në veprimtari informale, ose emigrojnë në vendet e Evropës

10

Perëndimore në kërkim të punës. Kjo varfëri të ardhurash i shtyn gratë të punojnë më shumë jashtë orarit, të bëjnë punë të dyta, ose të blejnë ushqime më të lira; të gjitha këto i lënë në varfëri absolute për sa i përket kohës. Pavarësisht se punojnë me orar të zgjatur, gratë kanë edhe barrën e përkujdesjes për familje të mëdha. Edhe kjo përkujdesje duhet të merret në konsideratë.

Këtë e shohim në kontekstin e gjerë të krizave sociale të vazhdueshme. Në fillim të viteve '90, rajoni post-socialist përjetoi "kthesën më akute të varfërisë dhe mirëqenies në botë" (PNUD 1999). Në raportin për Konferencën Ndërkombëtare të Punës (ILC), ILO dëshmon për një shpërbërje sociale drastike dhe shpërthim varfërie në këtë rajon. Rrjedhimisht, rajoni është tronditur nga nivele drastike të emigracionit që nga vitet 1990-1991. Në 30 vitet e fundit, ka regjistruar një prej humbjeve më të mëdha dhe të vazhdueshme të popullsisë. Që nga fillimi i viteve 1990, rreth 20 milion vetë (5.5% e popullsisë së Evropës Juglindore) vlerësohet se janë larguar nga ky rajon. Nga fundi i vitit 2012, Evropa Juglindore përjetoi një prej bjerrjeve më të mëdha të popullsisë, me rreth 16% të popullsisë që kishte në fillimin e viteve 1990.¹³ Nisur nga kushtet e pasigurisë, informalitetit dhe familjarëve që emigronin, familjet e mëdha u bënë rrjete mbështetjeje. Familjet e klasës punëtore pritet të jenë të mëdha dhe shpenzimet e këtyre familjeve më të mëdha se ato mesatare pritet të jenë më të ulëta.¹⁴

Prandaj, ne theksojmë dimensionin familjar të pagesës së jetesës, duke përdorur të njëjtin numër njësisish

Tabela: Llogaritja e pagës së jetesës ndërkufitare bazë, 2018¹³

Vendet e renditura sipas përqindjes ushqimore mesatare	Shpenzimet ushqimore të gjeneralizuara në PPP USD (tri njësi konsumi)	Grupet: ushqimi si përqindje e shpenzimeve familjare	Paga Minimale në Evropë (PME) në PPP USD, 2018	Paga Minimale në Evropë (PME) në monedhën vendase, 2018
Republika Çeke	792	30%	2,640	37,382
Hungaria	792	30%	2,640	409,754
Slovakia	792	30%	2,640	1,452
Polonia	792	30%	2,640	5,042
Bullgaria	792	30%	2,640	2,033
Turqia	792	30%	2,640	5,095
Kroacia	792	30%	2,640	10,428
Rumania	792	30%	2,640	5,069
Serbia	792	40%	1,980	98,030
Bosnja-Hercegovina	792	40%	1,980	1,604
Gjeorgjia	792	40%	1,980	1,762
Maqedonia e Veriut	792	40%	1,980	45,540
Shqipëria	792	40%	1,980	104,980
Ukraina	792	40%	1,980	14,197
Moldavia	792	40%	1,980	14,236

11. Bhattacharjee, A. dhe Roy, A. (2012) 'Paga Minimale në Azi dhe kontratat kolektive industriale globale', International Journal of Labour Research, Vol. 4, nr. 1, fq. 77.

12. Shih për shembull, Profili i Shtetit të Rumanisë në vitin 2019: <https://cleanclothes.org/livingwage/europe/country-profiles/romania/view>

13. Atoyán, R. et al. (2016) 'Emigrimi dhe ndikimi i tij ekonomik në Evropën Lindore', FMN, Punim Diskutimi Staf. <https://data.worldbank.org/indicator/PA.NUS.PRVT.PP>

konsumi si Paga Minimale në Azi, që konsistonte në tri njësi konsumi, **pra, më e lartë sesa familja mesatare në rajon.**

Gjithashtu, përdorëm monedhën me të cilën shprehet AFW-ja: **Pariteti i Fuqisë Blerëse (PPP USD)** i Bankës Botërore. Kjo monedhë virtuale u zgjodh për të pasur një shifër virtuale që të mund të konvertohej në të gjitha monedhat vendase, duke shmangur luhatjet e tregut dhe të politikave të këmbimit të valutës, si edhe duke marrë parasysh sadopak fuqinë blerëse të monedhave.

Ku devijuar nga metodologjia e Pagës Minimale të Azisë kur llogaritet pagën minimale në Evropë?

Me gjithë të përbashkëtat mes vendeve prodhuese në Azinë jugore, juglindore dhe lindore, si dhe në Evropën qendrore, lindore, dhe juglindore, ekzistojnë prapëseprapë disa faktorë kontekstualë dhe strukturorë që diktojnë përshtatjen e formulës. Na u desh të përshtatim **shpenzimet ushqimore si përqindje e pagës së jetesës**, si dhe **shpenzimet ushqimore** të punëtorëve me kontekstin evropian.

Për të llogaritur shpenzimet ushqimore, bëmë **vrojtime të shportës ushqimore të punëtorëve** në disa vende, me qëllim pasqyrimin sa më të mirë të realitetit të familjeve të klasës punëtore. Nga viti 2016 deri në 2019-ën, janë kryer vrojtime të shportës ushqimore në pesë vende, konkretisht në Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Ukrainë, Hungari dhe Moldavi. Janë përdorur edhe të dhënat për Rumaninë. **Mesatarja për shpenzimet ushqimore na rezultoi 792 PPP USD.**

11

Duke ndjekur metodologjinë e AFW-së, shpenzimet ushqimore mesatare duhet të pjesëtohen me shifrën e **ushqimit si përqindje e shpenzimeve familjare**. Sipas AFW-së, kjo përqindje ushqimore është aktualisht 45%, ndërsa në periudhën 2009-2020 ishte 50%. Me qëllim që të paraqesim shpenzimet ushqimore si përqindje të shpenzimeve familjare, në rastin e punëtorëve të industrisë së veshjeve në Evropë, u jemi referuar disa burimeve, duke përfshirë Statistikat Kombëtare, EuroStat dhe Indeks Global të Sigurisë Ushqimore të FAO-s. Në fakt, kjo përqindje ushqimore ndryshon ndjeshëm mes 15 vendeve të analizuara. Prandaj, pasi rakordua të dhënat empirike dhe analizuam të dhënat në grup, ramë dakord për dy grupe vlerash të pranueshme për përqindjen ushqimore: **30%** dhe **40%**. Si rezultat, dolën dy shifra për pagën e jetesës bazë për dy grupet shprehur në PPP USD. Pastaj, i konvertuam këto shifra në monedhat vendase. Më pas, këto paga të përftuara u krahasuan me pagën e jetesës që vlerësuan punëtorët në intervistat tona – dhe sërish verifikuam saktësinë gjatë mbledhjeve me Fokus Grupin Evropian për Prodhimin.

Në prill 2020, grupi i Clean Clothes Campaign në Evropën Lindore/Jugore miratoi konceptin dhe parametrat e kësaj page jetese ndërkufitare bazë.

Për vitin e referencës 2018, llogaritëm Pagën Minimale në Evropë në vlerën prej **1 980 PPD USD për Serbinë, Bosnjë-Hercegovinën, Gjeorgjinë, Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë, Ukrainën dhe Moldavinë**, si edhe **2 640 PPP USD për Sllovakinë, Hungarinë, Poloninë, Turqinë, Kroacinë, Republikën Çeke, Bullgarinë dhe Rumaninë.**

Tabela: Paga e jetesës ndërkufitare bazë evropiane e llogaritur në monedhë vendase, krahasuar me pagën neto minimale ligjore, 2018.

Vendet e renditura sipas përqindjes ushqimore mesatare	Paga Minimale në Evropë në monedha vendase, 2018	Paga neto minimale ligjore (2018) në monedhat vendase sipas CCC-ve në vend	Paga minimale neto si përqindje e PME-së
Republika Çeke	37,382	13,352	36%
Hungaria	409,754	126,770	31%
Sllovakia	1,452	397	27%
Polonia	5,042	1,530	30%
Bullgaria	2,033	395	19%
Turqia	5,095	1,603	26%
Kroacia	10,428	2,752	26%
Rumania	5,069	1,194	24%
Serbia	98,030	24,882	25%
Bosnja-Hercegovina	1,604	440	27%
Gjeorgjia	1,762	16	*
Maqedonia e Veriut	45,540	12,165	27%
Shqipëria	104,980	21,312	20%
Ukraina	14,197	2,997	21%
Moldavia	14,236	2,172	15%
MESATARJA			25%

Pagat minimale janë mesatarisht sa 25% e Pagës Minimale Evropiane

PAGA MINIMALE			EFW
----------------------	--	--	------------


Gjatë krahasimit, krahasuam Pagën Minimale në Evropë me pagat minimale ligjore kombëtare.

Në llogaritjet për të përcaktuar mesataren, e përjashtuam pagën minimale gjeorgjiane tejet të ulët sepse e ka burimin nga vitet 1990 dhe është pjesërisht relevante për këtë vend.

Tabela tregon se Paga Minimale në Evropë është 4 herë më e lartë sesa paga minimale e një vendi. Ky hendek konfirmon studimet e mëparshme në rajon.¹⁶

INFOGRAFIK:

Paga minimale ligjore neto si përqindje e pagës së jetesës bazë ndërkufitare në Evropë, në monedhë kombëtare, 2018. (Shifra e parë është vlera e pagës së jetesës bazë ndërkufitare; shifra e dytë është paga minimale ligjore neto)



*Pagën minimale gjeorgjiane tejet të ulët nuk e përfshimë në llogari, sepse është marrë si burim në vitet 1990, prandaj nuk është aq relevante për këtë vend.

16. <https://cleanclothes.org/campaigns/living-wages-in-europe>

Rruga përpara

1

Markat dhe kompanitë e veshjeve duhet të përcaktojnë hapa publikë, konkretë dhe të matshëm në të gjithë zinxhirin e tyre të furnizimit, që punëtorët e industrisë së veshjeve të marrin një pagë jetese brenda një harku kohor të arsyeshëm. Markat e modës dhe shitësit me pakicë duhet të negociojnë dhe të nënshkruajnë marrëveshje ligjërish të detyrueshme dhe të zbatueshme me përfaqësuesit e punëtorëve të cilët kërkojnë pagesën e çmimit të vërtetë të produktit që ata porosisin nga furnitorët e tyre - një çmim që mundëson përmbushjen e të drejtës së njeriut për një pagë jetese - pagë jetese që duhet të paguhet, një pagë me të cilën punëtorët dhe familjet e tyre mund të jetojnë.

2

Qeveritë si në vendet e konsumit ashtu edhe në vendet prodhuese në Evropë, si dhe BE-ja, kanë për detyrë të mbrojnë të drejtën njerëzore të punëtorëve për një pagë jetese dhe të implementojnë paga minimale ligjore të cilat e luftojnë varfërinë dhe nuk krijojnë një fuqi punëtore të varfër dhe të përjashtuar nga shoqëria.

Standardi i pagës së jetesës që duhet të merret në konsideratë nga markat e modës dhe shitësit si dhe qeveritë dhe BE-ja është si vijon: **për Sllovakinë, Hungarinë, Poloninë, Turqinë, Kroacinë, Çekinë, Bullgarinë dhe Rumaninë, kjo është PPP 2,640 USD, dhe për Serbinë, Bosnjë-Hercegovinën, Gjeorgjinë, Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë, Ukrainën dhe Moldavinë, shifra qëndron në PPP 1,980 USD (2018).**

Clean Clothes Campaign



Clean Clothes Campaign (CCC) është një rrjet global organizatash pune dhe organizatash të të drejtave të njeriut, ku përfshihen edhe sindikatat. Qëllimi i tij është promovimi dhe avokimi i përmirësimit të kushteve të punës në industrinë tekstile dhe të veshjeve sportive. CCC përdor studime me karakter veprimi për të ndërmarrë fushata mbi strategjitë e saj avokuese dhe lobuese në përpjekje për të sjellë në vëmendje të drejtat e njeriut në sektorin e industrisë tekstile. Në thelb të veprimtarisë së saj shtrihet e drejta e njeriut për pagë jetese, pasi ky është edhe thelbi i ankesave të punëtorëve.

Contact: europe-east-south@cleanclothes.org
<https://cleanclothes.org/campaigns/living-wages-in-europe>

Grupi i CCC-së që hartoi dhe miratoi këtë koncept dhe parametër është **Fokus Grupi Evropian për Prodhimin/grupi Evropa Lindje/Jug**, cili përbëhet nga:

Shqipëria: Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim (QAGJZH);

Bullgaria: Kolektivi për Ndërhyrjet Sociale;

Koalicioni kombëtar i CCC-ve Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci (që përbëhet nga Novi Sindikat / Sindikata e Re, Regionalni industrijski sindikat (RIS) / Sindikata Industriale Rajonale, Hrvatski centar za radničku solidarnost (HCRS) / Qendra Kroate për Solidaritetin e Punëtorëve, Fundacija za lokalni ekonomski razvoj (FLER)/ Fondacioni për Zhvillimin Ekonomik Vendor, Helsinški parlament građana/ Parlamenti i Qytetarëve i Helsinkit);

Koalicioni kombëtar CCC i Çekisë;

Gjeorgjia: Konfederata e Sindikatave Gjeorgjiane;

Hungaria: Shoqata e Konsumatorëve të Vetëdijshëm;

Maqedonia e Veriut: Porta e Hapur – La Strada;

Moldavia: Qendra për Politika, Nisma dhe Kërkim Shkencor "Platforma";

CCC Poloni – Fondacioni "Bli me Përgjegjshmëri" (BRF);

Rumania: Asociația Mai Bine

CCC Serbi – Qendra për Politika të Emancipimit (CPE);

Sllovakia: Qendra Sllovake për Komunikim dhe Zhvillim (SCCD);


CCC Turqi

Ukraina: Uorkshopi Feminist

CCC Zvicër

CCC Itali

Gjermania: Entwicklungspolitisches Netzwerk Sachsen e.V.ENS (rrjeti i hartimit të politikave) – anëtar i CCC Gjermani

Sindikatat:**OSHC-të:**

Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Entwicklungspolitisches
Netzwerk Sachsen e.V.

**Brot für die Welt**

Përmbajtja e këtij publikimi është nën përgjegjësinë e plotë të CPE-së dhe nuk duhet marrë se pasqyron qëndrimin e Brot für die Welt (Bukë për Botën).



Mbështetur nga Fondacioni Rosa Luxemburg për Evropën Juglindore me fonde të Ministrisë së Jashtme Federale të Gjermanisë. Kushdo mund ta përdorë këtë botim plotësisht ose pjesërisht, me kusht që të shënojë si referim botimin origjinal.



Transform! europe financohet pjesërisht nga një grant i Parlamentit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është nën përgjegjësinë e plotë të CPE-së dhe nuk duhet marrë se pasqyron qëndrimin transform! europe.



Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian

Paguani punëtorët me

PAGË JETESE



Ata duhet të jenë
në gjendje të
përballojnë:



ushqimin



qeranë



kujdesin
shëndetësor



arsimimin



rrobat



transportin



kursimet



Paga e jetesës është një e
drejtë njerëzore, për të
GJITHË njerëzit, në të
GJITHË botën